



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së
SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (22) F. 4-5

MUNGESA E KONSENSUSIT POLITIK E LA KOSOVËN PA INSTITUCIONE TË PËRKOHSHE DREJTUESE!



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së njëzetedy, ka folur për mungesën e konsensusit politik që la Kosovën pa institucione të përkohshme drejtuese, për

angazhimin e kryeministrit Thaçi për mbështetjen ndërkombëtare për transformimin e një pjese të UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Bardhyl Mahmuti gjithashtu ka folur edhe për raportet që kishte Qeveria e Përkohshme e Kosovës me

strukturën e Misionit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (UNMIK). Mahmuti në këtë intervistë tregon se pse Bernard Kouchner ishte i vetmi që kishte kompetencë të fliste për Kosovën në skenën politike ndërkombëtare

'KOSOVA DHE
SHQIPËRIA
DUHET TË KENË
SYNIME TË
PËRBASHKËTA
NË INTERES TË
DY SHTETEVE' F. 6



KDI-ja: TRENDI
NË RITJE I
SHKELJES SË
TË DREJTAVE TË
PUNËTORËVE
EDHE NË SEKTORIN
PUBLIK F. 3



AKTUALE



I JEPET LAMTUMIRA SHKRIMTARIT
ADEM GASHI F. 5

ISMET KRASNIQI EMËROHET
KËSHILLTAR I PRESIDENTES OSMANI F. 6

PJESËTARËT E FSK-së DHE PERSONELI
I MINISTRISË SË MBROJTJES
DO TË UDHËTOJNË PA VIZA PËR NË
MBRETËRINË E BASHKUAR F. 7

EKONOMI



SHALA: PAGA MINIMALE PREJ
264 EUROVE E PAMJAFTUESHME,
INSTITUCIONET DUHET
TË SHOQETËSOHEN F. 8

KURTI NË CYRIH, MERR PJESË NË
HAPJEN E SALLONIT TË MOBILIEVE
TË PRODHUARA NË KOSOVË F. 8

SPORT



XHAKA: JAM SI VERA E KUQE,
GJITHMONË E MË I MIRË F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OBSH-ja: Vaksinat kundër Covid-it shpëtuan 1.4 milion jetë në Evropë

GENEVË, 16 JANAR - Të paktën 1.4 milion jetë janë shpëtuar në Evropë falë vaksinave kundër Covid-19, tha Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), duke ripërsëritur se virusi ende nuk është zhdukur.

Në rajonin evropian të OBSH-së - ku përfshihen 53 shtete, edhe ato në Azinë Qendrore janë regjistruar 277.7 milionë raste me Covid-19 dhe mbi 2.2 milionë vdekje, sipas të dhënave më të fundit, që datojnë që nga dhjetori i vitit 2023. "Sot, 1.4 milion njerëz në rajonin tonë - shumica të moshuar po e shijojnë jetën me

më të dashurit e tyre për shkak se u vaksinuan kundër Covid-19", tha drejtori për Evropë në OBSH, Hans Kluge. "Vetëm doza e parë vlerësohet se ka shpëtuar 700.000 jetë".

Kluge tha se është qenësore që njerëzit të mbrohen gjatë dimrit, veçmas ata që janë më të cenueshëm. "Teksa ne mësohemi të jetojmë me Covid-19 dhe me viruset e tjera që prekin organet e frymëmarrjes, është absolutisht thelbësore që popullata, që është më e cenueshme që t'i rri gati vaksinimit kundër Covid-it dhe

të vaksinohet edhe kundër gripit sezonal".

Ai insistoi që Evropë duhet të vazhdojë të investojë në sistemet e kujdesit shëndetësor.

Kluge tha se duhen po ashtu më shumë fonde për të adresuar çështjen e mungesës së punëtorëve shëndetësorë dhe furnizimeve me ilaçe esenciale. Sëmundja e koronavirusit fillimisht u shfaq në Vuhan të Kinës në fund të vitit 2019 dhe më pas virusi u përhap në mbarë botën. Në botë janë regjistruar mbi 701 milionë raste me Covid dhe afër 7 milionë viktima.



I ftohti mbërthen ShBA-në: Mbyllen shkollat dhe anulohen fluturimet

NJU JORK, 16 JANAR - Erëra të ftohta dhe të rrezikshme kanë vazhduar të mbizotërojnë në pjesë të Shteteve të Bashkuara, ku temperaturat kanë arritur deri në minus 30 gradë celsius.

Rreth 110.000 shtëpi dhe biznese mbetën pa energji elektrike të hënën mërzë, shumica prej të cilave në Oregon, shtet që po përballet me ndërprerje të rrymës që nga dita e shtunë. Kompania publike për furnizim me energji, Portland General Electric, ka paralajmëruar se kërcënimi nga shiu dhe i ftohti mund të shkaktojë vonesa në rikthimin e furnizimeve të rregullta me energji elektrike.

Zyrtarët e transportit u kanë bërë thirrje banorëve që t'i shmangin udhëtimet, pasi që rrugët pritet të bëhen të rrezikshme nga shtresat e akullit, por edhe mund të ketë rrëzime të pemëve dhe të shtyllave elektrike.

Mësimi është anuluar për nxënësit në Portlënd dhe në



qytete të tjera të mëdha sikurse Çikago, Denver, Dallas dhe Fort Uorth.

Stuhitë dhe temperaturat e ulëta

kanë prekur gjithçka nga udhëtimet ajrore, ndeshjet sportive, e deri te votimet brendapartiake në Ajova, e po

ashtu kanë shkaktuar disa raste vdekjesh në mbarë vendin.

Të paktën katër persona kanë vdekur në zonën e Portlëndit,

përfshirë dy persona që dyshohet se vdiqën nga hipotermia. Një tjetër burrë vdiq pasi një pemë ra mbi shtëpinë e tij, ndërkaj një grua vdiq nga zjarri që u përhap pasi në stufën e kuzhinës ra një pemë.

Në Uiskonsin, autoritetet po hetojnë vdekjen e tre të pastrehëve, të cilët ka të ngjarë që kanë vdekur nga hipotermia, thanë zyrtarët.

Shiu i ftohtë dhe reshjet e borës janë parashikuar që të mbërthejnë juglindjen të martën.

Ndërkaq, në Misisipi të hënën mërzë temperaturat ranë nën minus 12 gradë celsius.

Për shkak të motit të ftohtë, Flight Aware, që gjurmon fluturimet, tha se rreth 2.900 fluturime janë anuluar të hënën në ShBA.

Temperaturat pritet të ngrihen në mesin e javës, por erëra të ftohta janë parashikuar në jug gjatë fundit të javës.

Trump fiton zgjedhjet partiake në Ajova

UASHINGTON, 16 JANAR - Ish-presidenti amerikan, Donald Trump, ka shënuar fitoren e dytë me radhë në zgjedhjet brendapartiake në Ajova, përdërisa la shumë prapa rivalët e tij, një fitore që e çon më afër fitimit të nominimit të Partisë Republikane për zgjedhjet presidenciale të këtij nëntori.

Në votimet, ku pjesëmarrja ishte më e ulët në çerek shekullin e fundit, pjesëmarrësit votuan në kushte të rënda atmosferike. Votimet brendapartiake u mbajtën në qindra shkolla, kisha dhe qendra të komunitetit në mbarë Ajovën.

Trump fitoi 30 pikë, duke thyer rekordin e zgjedhjeve

brendapartiake në Ajova, pasi më 1988 Bob Dole kishte shënuar një fitore prej 13 pikësh. Guvernatori i Floridës, Ron DeSantis doli i dyti, ndërkaj e treta ish-ambasadorja e ShBA-së në Kombet e Bashkuara, Nikki Haley.

Rezultatet në Ajova i japin shans të mirë Trumpit për të fituar nominimin e republikanëve, edhe pse do të duhen edhe disa muaj që njëri nga kandidatët zyrtarisht të bëhet i nominuar për president nga kjo parti.

Përdërisa në muajt e fundit është zotuar për hakmarrje ndaj kundërshtarëve politikë, Trump në fjalimin e tij përcolli mesazh të unitetit. "Ne duam të

bashkohemi, qoftë nëse jeni republikan, demokrat, liberal apo konservator. Ne do të bashkohemi. Kjo do të ndodhë së shpejti", tha ai.

Tani gara brendapartiake në mesin e republikanëve do të zhvendoset në Nju Hempshajër, ku do të zhvillohen votime më 23 janar.

Ndërkaq, në Karolinën e Jugut më 24 shkurt do të mbahen votimet, të cilat mund të jenë shumë të rëndësishme. DeSantis të martën zhvilloi fushatë atje.

Haley ndërkaj, pritet të mbajë fushatë në Nju Hempshajër, ku shpreson që të jetë e suksesshme për të fituar mbështetjen e votuesve të pavarur.



Votimi në Ajova ishte i fshehtë.

Demokratët në Ajova, ndaras, në këtë cikël zgjedhor do të zgjedhin kandidatin e tyre për president

duke votuar krejtësisht përmes postës. Rezultatet do të publikohen më 5 mars, gjatë Super të Martës.

“Kosova dhe Shqipëria duhet të kenë synime të përbashkëta në interes të dy shteteve”

Rivitalizimi i procesit të njohjes ndërkombëtare të Kosovës, në bashkërendim me vendet partnere, si dhe anëtarësimi në organizata rajonale e ndërkombëtare, përfshirë edhe A5 ku Shqipëria ka Presidencën për këtë vit, mbeten prioritet kryesorë të punës së të përbashkët. Kështu ka thënë të martën në Prishtinë ministri për Evropë dhe Punë të Jashtme i Shqipërisë, Igli Hasani

EPOKA ERE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 16 JANAR- Duke e cilësuar si “lojë qesharake”, ministri për Evropë dhe Punë të Jashtme i Shqipërisë, Igli Hasani, i bëri thirrje Serbisë që të ndalojë së dërguari ushtrinë e saj në kufi me Kosovës. Hasani, gjatë një konference të përbashkët për media në Prishtinë me homologen e tij nga Kosova, Donika Gërvalla, tha se siguria e Kosovës garantohet nga NATO. “Bëjmë thirrje te të gjithë aktorëve dhe faktorëve që jetojnë në shekullin e 21-të, nuki çohen ushtri

dhe hapat drejt të ardhmes së përbashkët euro-atlantike. “Rivitalizimi i procesit të njohjes ndërkombëtare të Kosovës, në bashkërendim me vendet partnere, si dhe anëtarësimi në organizata rajonale e ndërkombëtare, përfshirë edhe A5 ku Shqipëria ka Presidencën për këtë vit, mbeten prioritet kryesorë të punës së të përbashkët”, ka theksuar ai. Homologia e tij, Donika Gërvalla, duke folur për Banjskën, sërish i bëri thirrje faktorit ndërkombëtar që të sanksionojë Serbinë. “Mungesa e ndëshkimit bart në



përfaqësuesit e BE-së, Francës, Gjermanisë dhe Italisë. Kryeministri kosovar ka deklaruar se në këtë takim ka pranuar propozimin për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe dhe ka qenë i gatshëm të nënshkruajë marrëveshje për normalizim të raporteve, por kjo është kundërshtuar nga lideri serb. Gërvalla tha se me takimin e 26 tetorit, topi tashmë ka kaluar në fushën e BE-së. “... topi ka kaluar te BE-ja dhe është radha e ndërmjetësuesve që të sjellin në tavolinë Serbinë me një qasje konstruktive për të nënshkruar marrëveshjet të cilat janë lidhur vitin e kaluar. As masat [ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës], as arsyetimet nuk mund të hedhin errësirë mbi faktin që topi që është te BE-ja duhet të lëvizë”, tha Gërvalla. Edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Igli Hasani, me të cilin përpos zhvillimeve të fundit politike dhe ato të sigurisë u diskutua edhe nevoja për koordinimin e vazhdueshëm ndërshtetëror në politikën e jashtme. Shqipëria, sipas Osmanit e ka

mbështetur Kosovën përgjatë periudhave të rënda për popullin e saj, sikurse edhe në procesin e shtetformimit dhe shtetndërtimit, ndaj ka falënderuar ministrin Hasani dhe shtetin shqiptar. Në takim me ministrin Hasani, presidentja Osmani ka theksuar se Kosova ka nevojë edhe më tej për mbështetjen e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, sidomos në organizatat në të cilat nuk është e përfaqësuar. “Përtej lidhjes historike e partneritetit strategjik, Kosova dhe Shqipëria duhet të kenë synime të përbashkëta dhe strategji të harmonizuara në interes të dy shteteve”, ka theksuar Osmani. Presidentja Osmani ka potencuar se forcimi i shtetit të Kosovës dhe konsolidimi i pozicionit ndërkombëtar është synim i vazhdueshëm, i cili ka nevojë edhe për mbështetjen e Shqipërisë. “Pozita e Kosovës në arenën ndërkombëtare ka nevojë për kontribut të vazhdueshëm të politikës së jashtme të Shqipërisë”, është shprehur presidentja Osmani, duke theksuar se për Kosovën, Shqipëria është jo vetëm një partner strategjik, por edhe shtet me të cilin ka lidhje vëllazërore, kulturore e kombëtare. Në këtë kontekst, Osmani dhe

ministri Hasani diskutuan edhe për koordinimin për çështjen e njohjeve të reja, përfshirjen në Partneritetin për Paqe si një hap paraprirës i anëtarësimit në NATO, por edhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Në raport me zhvillimet e fundit me situatën politike dhe të sigurisë, presidentja Osmani ka theksuar se institucionet e Kosovës janë te përkushtuara për koordinim dhe bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar dhe vendet mike të rajonit në adresimin e sfidave të sigurisë. Sipas Osmanit, zhvillimet e fundit në veriun e Kosovës dhe veprimet armiqësore të Serbisë dhe lidhshimit të saj, kërkojnë angazhim dhe vëmendje të shtuar të faktorit ndërkombëtar por edhe të vendeve të rajonit në funksion të ruajtjes së paqes dhe stabilitetit. Ministri për Evropë dhe Punë të Jashtme i Shqipërisë, Igli Hasani, është takuar edhe me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufcën. “Me kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca vlerësuam bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve tona dhe theksova rëndësinë e zgjerimit të dialogut politik përmes diplomacisë parlamentare”, ka bërë me dije Hasani.



fqinjët më te kufiri. Askush nuk duhet të bëjë më këtë lojë që është qesharake sepse të gjithë jemi të qartë se garancia më e madhe për integritetin dhe sovranitetin e Kosovës është NATO, ku dhe Shqipëria është pjesë”, tha Hasani. Vitin e kaluar, pas rritjes së tensioneve mes Kosovës dhe Serbisë, Beogradi zyrtar ka dërguar disa herë ushtrinë e saj pranë kufirit me Kosovën, gjë që ka nxitur Shtetet e Bashkuara t’i bëjnë thirrje që të tërhiqen trupat serbe. Hasani, që po qëndron në Kosovë në vizitën e tij të parë zyrtare, foli për sulmin e 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit. Atë ditë, një grup serbësh të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës, duke vrarë një polic. Në përlshjet që pasuan u vranë edhe tre sulmues serb. Kryediplomati shqiptar bëri thirrje që përgjegjësit për sulmin, që ai e cilësoi terrorist, duhet të përballen me drejtësinë, pasi sipas tij, kjo është e domosdoshme “për të parandaluar një përshkallëzim me pasoja ndoshta të pakthyeshme”. Duke folur për bashkëpunimin Shqipëri Kosovë, Hasani ka theksuar se me Gërvallën diskutuan mbi intensifikimin me projekte konkrete të marrëdhënieve tona strategjike,

vetvete rrezikun e përsëritjes. Prandaj, jo vetëm për hir të paqes dhe sigurisë së Kosovës dhe qytetarëve të saj, por sidomos për hir të paqes dhe stabilitetit afatgjatë në gjithë rajonin tonë, bashkësia ndërkombëtare duhet të mos mbetet e heshtur, por të ndëshkojë ashpër çdo tentativë për të destabilizuar vendet fqinje”, tha ajo. Sipas ministrit Hasani, siguria dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor “janë më të kërcënuara sesa në çdo moment tjetër gjatë dekadës së fundit”. Të dy kryediplomatët u ndalën edhe te dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Hasani tha se më 26 tetor në Bruksel, Albin Kurti, pranoi “pa kushte” që të nënshkruajë Marrëveshjen drejt normalizimit të raporteve. Kryediplomati shqiptar tha se të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun e Brukselit duhet të zbatohen. “Ne u bëjmë thirrje partnerëve tanë ndërkombëtarë që të ruajnë këtë moment dhe të shtyjnë përpara drejt një përparimi përfundimtar”, tha Hasani. Më 26 tetor, në takime të ndara, Kurti dhe presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, u takuan me





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (22)

Mungesa e konsensusit politik e la Kosovën pa institucione të përkohshme drejtuese!

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së njëzetedy, ka folur për mungesën e konsensusit politik që la Kosovën pa institucione të përkohshme drejtuese, për angazhimin e kryeministrit Thaçi për mbështetjen ndërkombëtare për transformimin e një pjese të UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Bardhyl Mahmuti gjithashtu ka folur edhe për raportet që kishte Qeveria e Përkohshme e Kosovës me strukturën e Misionit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (UNMIK). Mahmuti në këtë intervistë tregon se pse Bernard Kouchner ishte i vetmi që kishte kompetencë të fliste për Kosovën në skenën politike ndërkombëtare

PRISHTINË, 16 JANAR - “Epoka e re”: Një ndër hapat e parë që ndërmorën autoritetet ndërkombëtare në Kosovë pas vendosjes së pranisë civile dhe ushtarake ishte përpjekja për “çarmatosjen e UÇK-së”. A patën nevojë ndërkombëtarët për autoritetin e kryeministrit Thaçi për t’i bindur komandantët e zonave operative dhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm që të pranonin këtë proces, apo kishte arsye të tjera të përfshirjes së tij në këtë proces?

Bardhyl Mahmuti: Ndërhyrja e kryeministrit Thaçi në këtë proces nuk kishte të bënte me ndikimin e tij në strukturat ushtarake të

UÇK-së, por për arsye të garancive gojore që kishte marrë nga diplomatët amerikanë për ruajtjen e një forme të forcave të armatosura të Kosovës, në kohën kur ishte udhëheqës i delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë. Ai u angazhua maksimalisht në këtë proces dhe arriti të sigurojë mbështetjen ndërkombëtare për transformimin e një pjese të UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, ndërsa një pjesë tjetër ta përfshihej në kuadër Policisë së Kosovës e cila, me asistencën ndërkombëtare, u ndërtua si strukturë profesionale e ruajtjes së rendit publik. Fatmirësisht pjesa

dërmuese e Shtabit të Përgjithshëm e kuptuan rëndësinë që kishte krijimi i TMK-së si bërthamë e ushtrisë së ardhshme të Kosovës.

“Epoka e re”: A pati të tillë që nuk e pranuan këtë transformim?

Bardhyl Mahmuti: Krijimi i UÇPMB-së, Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe organizatës me akronim AKSH janë indikatorë të mungesës së konsensusit në radhën e strukturave ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mendoj se kemi pasur fat që në momentet kyçe për Kosovën, gjenerali Agim Çeku ishte në krye të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-

së. Përndryshe rrjedhat kishin mundur të merrnin kahe negative.

“Epoka e re”: Cilat ishin raportet që kishte Qeveria e Përkohshme e Kosovës me strukturën e Misionit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (UNMIK)?

Bardhyl Mahmuti: Raportet ishin tepër të mira, por problemi qëndronte në cenimin e legjitimitetit të Qeverisë së Përkohshme. Megjithatë kishte një marrëveshje të forcave politike në Rambuje për krijimin e kësaj strukture qeverisëse, LDK-ja e Ibrahim Rugovës nuk pranoi ta zbatonte. Nuk do të hyj të gjykoj për arsyet e një veprimi të tillë për arsye se nuk i di të gjitha gjërat që janë zhvilluar rreth kësaj çështjeje. Por atë që e shihnim në kontakte me jashtë dhe me përfaqësuesit e UNMIK-ut, mospërfshirja e LDK-së në këtë qeveri ishte pengesë që të njiheshim si përfaqësues legjitim të Kosovës.

“Epoka e re”: Kur u emëruat ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës në Qeverinë e Përkohshme ju dhatë një deklaratë nëpërmjet secilës ftonit LDK-në t’i

bashkëngjitej qeverisë.

Bardhyl Mahmuti: Sipas asaj që më ishte thënë, në marrëveshjen që kishin pasur forcat politike shqiptare në Rambuje, Ministria e Punëve të Jashtme duhej t’i takonte LDK-së. Për këtë arsye, në deklaratën e parë pas emërimit tim unë sqarove se kam pranuar këtë funksion në mungesë të pranisë së tyre. Por nga momenti që do të pranojnë të jenë pjesë e Qeverisë së Përkohshme unë u shpreha pa asnjë ambiguitet se do t’ia lëshoja detyrën personit që do të ngarkohej nga kjo parti. Madje u bëra thirrje që të bashkoheshin në interes të proceseve që na dilnin si sfida të rënda përpara!

“Epoka e re”: Deri në fund, LDK-ja refuzoi të bëhej pjesë e Qeverisë së Përkohshme! Si e shihni veprimin e tillë?

Bardhyl Mahmuti: Nuk më takon të gjykoj për një marrëveshje pjesë e secilës nuk kam qenë. Mirëpo mungesa e konsensusit brenda forcave politike shqiptare në Kosovë bëri që, më 31 dhjetor 1999, të pushojë funksionimin e vet Qeveria e Përkohshme e Kosovës. Krijimi i Këshillit

administrativ nën drejtimin e Bernard Kouchner-it ku u përfshinë LDK-ja, PDK-ja dhe LBD-ja (më vonë edhe Rada Trajković si përfaqësuese e serbëve të Kosovës) i dha fund mundësisë që Kosova të kishte zërin e vet në skenën politike ndërkombëtare.

“Epoka e re”: Në çfarë kuptimi Këshillit administrativ i krijuar nga UNMIK-u, pamundësoi Kosovën të kishte zërin e vet në skenën politike ndërkombëtare?
Bardhyl Mahmuti: Gjatë gjithë kësaj kohe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovë, Bernard Kouchner ishte i vetmi që kishte kompetencë të fliste për Kosovën. Të gjithë liderët e tjerë mund të flisnin vetëm në emër të partive politike që udhëhiqni.

“Epoka e re”: Mendoni se mungesa e konsensusit brenda forcave politike shqiptare të Kosovës ia pamundësoi autoriteteve ndërkombëtare të pranonin Qeverinë së Përkohshme si autoritet legjitim të Kosovës?
Bardhyl Mahmuti: Jam i sigurt, sepse ata na pritën deri më 31 dhjetor 1999 që të arrinim një gjë të tillë. Unë kam qenë pjesë e diskutimeve të shumta me Bernard Kouchner-in rreth kësaj teme dhe e di se pa marrë parasysh kush do të drejtonte Qeverinë e Kosovës, nëse ajo do të përkrahej nga të gjitha forcat politike, do të njihej si autoritet legjitim deri në zgjedhjet e lira që do të organizoheshin në përputhje me rezolutën 1244.

“Epoka e re”: A e ka dëmtuar Kosovën mungesa e zërit të saj në skenën politike ndërkombëtare?
Bardhyl Mahmuti: Po, në shumë aspekte! Sikur të ishim të gjithë të një qëndrimi politik, faza kalimtare do të zgjaste tri vite dhe procesi i zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës do të fillonte shumë më herët. Në ndërkohë kanë ndodhur ngjarje shumë të rënda në skenën

politike ndërkombëtare, kur Kosova do të duhej të fliste me një gjuhë, apo në rrafshin e brendshëm, ku margjina e veprimeve tona ishte tejet e kufizuar.

“Epoka e re”: Për cilat ngjarje e keni fjalën?
Bardhyl Mahmuti: Në rrafshin e skenës politike ndërkombëtare, atentatet terroriste të 11 shtatorit 2001 krijuan një kontekst të ri ku dinamika e diplomacisë së shteteve perëndimore u zhvendos gjetiu. Rrethanat e reja i mundësuan Serbisë t’i rikthehet fushatës së tërbuar kundër nesh dhe të aktivizojnë tërë arsenalin propagandistik për të prezantuar Kosovën si trampolinë e rrezikut që i kanoset perëndimit nga fundamentalizmi islamik. Ndërkaq në kuadër të territoreve shqiptare në Kosovë, në Luginë të Preshevës dhe në Maqedoni, Serbia dhe shërbimet sekrete jugosllave mobilizuan agjentët e tyre të përkatësisë etnike që të punojnë në përforcimin e imazhit të “shqiptarit islamik”! Fatkeqësisht veprimet e disa shqiptarëve çuan ujë në mullirin që bluante miell për gatesat e kuzhinës serbe!

“Epoka e re”: Ju flisni për rikthim të fushatës serbe për të prezantuar Kosovën si trampolinë e rrezikut që i kanoset perëndimit nga fundamentalizmi islamik! Siç e thatë më lartë, kjo akuzë ishte e pranishme gjatë vitit 1997-1998. A pati momente kur kjo akuzë u hoq nga arsenal i propagandistik i Serbisë?
Bardhyl Mahmuti: Propaganda për gjoja lidhjet e UÇK-së me ideologjinë e ekstremizmit fetar islam dhe për gjoja “instruktorë të fundamentalizmit islamikë, që stërvitnin ushtarët e UÇK-së”, nuk gjeti mbështetje të gjerë, siç kishin shpresuar udhëheqësit e propagandës së regjimit të Beogradit. Përveç disa artikujve në gazeta, ku shihej ndikimi i kësaj propagande, përpjekjet për të paraqitur UÇK-në si “organizatë terroriste me



pikëpamje fundamentaliste islamike” kishin dështuar. Zhgënjimin e autoriteteve serbe për këtë dështim e shprehu publikisht sekretari federativ i atëhershëm i informacionit, Goran Matić (Matiq). Në një intervistë ekskluzive për gazetën “Medjunarodna politika”, të datës 29 gusht 1998, ai deklaroi: “është e pabesueshme se si fundamentalistët islamikë cilësohen si terroristë vetëm kur vrasin amerikanë. Ndërsa kur vrasin qytetarë të pafajshëm të Jugosllavisë, ata cilësohen si luftëtarë të drejtësisë”. Dështimi i propagandës për gjoja “instruktorë fundamentalistë islamikë që stërvitnin ushtarët e UÇK-së” dhe sidomos qëndrimet e institucioneve ndërkombëtare kundër dhunës së forcave të armatosura policore dhe ushtarake serbe e tërbuan pushtetin e Beogradit. Ky tërbim mori përmasat e një histerie, veçanërisht pas denoncimit që William Walker-i i bëri vrasjes së civilëve shqiptarë në fshatin Reçak. Kualifikimi i Walker-it, se ajo që kishte ndodhur në këtë

fshat “ishte krim kundër njerëzimit” dhe se “ata që kishin dhënë urdhër për këtë krim duhej të jepnin llogari para drejtësisë”, bëri që “instruktorët e fundamentalizmit islamik që stërvitnin ushtarët e UÇK-së” të harroheshin përkohësisht nga propaganda e Beogradit. Ata u “zëvendësuan” me “instruktorë ose specialistë me mbiemra amerikanë ose anglezë që kishin ardhur të stërvitnin ushtarët e UÇK-së...”!!!

“Epoka e re”: Si shpjegohet ky paradoks i ndërrimit të akuzave varësisht nga konteksti politik ndërkombëtar?
Bardhyl Mahmuti: Nuk brengosen fare nga paradokset që mund të dalin në shesh nga fakti se e njëjta strukturë herë akuzohej të jetë e trajnuar nga “fundamentalistët islamikë”, e herë nga “ekspertët e shërbimeve sekrete anglo-saksone”! Krahas stigmatizimit të shërbimeve sekrete amerikane dhe britanike, si të implikuar në “përgatitjen e terroristëve shqiptarë”, nuk mungojnë autorët që implikojnë

edhe Shërbimin Sekret Francez dhe atë Gjerman në lidhjet me UÇK-në. Kjo strategji, sado paradoksale të duket, është e qëllimshme. Të gjitha shoqëritë perëndimore që përballeshin me aksione terroriste me konotacion religjioz fundamentalist islamik, duhej të shihnin rrezik nga lufta çlirimtare e Kosovës. Ndërsa vendet arabo-islamike ta shihnin UÇK-në si “instrument të imperializmit amerikan”. Për ta kompletuar akuzën se gjoja “komploti kundër Serbisë vjen nga jashtë”, shteti serb denoncoi edhe “tolerancën” e shteteve të demokracive perëndimore në raport me “terroristët shqiptarë”. Këto akuza u drejtuan në veçanti kundër “tolerancës” së autoriteteve gjermane dhe zvicerane. Sipas “Librit të Bardhë” të Shërbimit Sekret të Serbisë, “autoritetet gjermane ia kishin lënë UÇK-së kazernat e braktisura të NATO-s (në Hanover, në Nuremberg, në Bon dhe në Frankfurt) dhe qindra kampe të azilërkuesve, ndërsa autoritetet e Zvicrës i paskëshin lejuar “kampet paramilitare private, sallat e guajtjes me armë dhe klubet e sporteve luftarake për nevojat e UÇK-së”!!! Me një fjalë, sipas propagandës serbe, shumë shtete perëndimore ishin mobilizuar në kuadër të një komploti kundër Serbisë! Përkundër faktit se pas krimeve në fshatin Reçak “instruktorët anglo-amerikanë” dolën në rrafshin e parë propagandistik të regjimit të Milosheviqit, ndërrimi i “instruktorëve islamikë fundamentalistë” me “instruktorët anglo-amerikanë” nuk e hoqi tërësisht propagandën serbe që synonte përafrimin e UÇK-së me grupet terroriste islamike. Në të gjitha ribotimet e mëvonshme të “librave të bardhë”, kjo njolllosje mundahej të mbahej gjallë duke u ilustruar me sajime të reja, që plasoheshin në opinionin publik ndërkombëtar si “argumente”.
(Muhamet Mavraj / Vijon)

I jepet lamtumira shkrimtarit Adem Gashi

Drenas, 16 janar- Në fshatin Nekoc të Drenasit i është dhënë të martën lamtumira e fundit shkrimtarit Adem Gashi, i cili ndërroi jetë në moshën 70-vjeçare. Me rastin e vdekjes së shkrimtarit të shquar Adem Gashit, ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ka ngushëlluar familjen Gashi, duke theksuar se ikja e tij do të lë mungesë në krijimtarinë letrare por veprimtaria e tij artistike e lënë si trashëgimi do të mbetet referencë për brezat e ardhshëm. Shkrimtarin Adem Gashi do ta kujtojmë gjithmonë si një njeri modest, atdheadashës e punëtor të zellshëm, i cili vazhdimisht ka krijuar vepra të cilat edhe u shndërruan në himne këngësh që me ëndje i kemi dëgjuar dhe do t’i dëgjojmë edhe në të ardhmen”, ka thënë Çeku.

Edhe kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci ka ngushëlluar familjen e tij, duke cekur se: “komuna jonë dhe kombi, humbi shkrimtarin e shquar, mendimtarin dhe atdhetarin Adem Gashi, i cili historinë tonë të re, ngjarjet me peshë për kombin, i përcolli me shkrime, analiza dhe krijime të cilat e bëjnë të paharrueshëm për kulturën, artin dhe botën e letrave shqipe. Adem Gashi, ishte kronikan që për mbi gjysmë shekulli trajtoi, përshkroi dhe promovoi me vëmendjen dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm, ndjenjën, besimin, dashurinë dhe jetën tonë në prizmin e atdhetarizmit të kulluar me libra, me shkrime dhe paraqitjet me peshë për kulturën nacionale”, ka shkruar Lladrovci në “Facebook”.



Hyseni e Durmishi nënshkruajnë projektin infrastrukturor për qytetin e Gjilanit në vlerë 27 milionë euro

GJILAN, 16 JANAR - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni dhe zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi kanë nënshkruar një projekt infrastrukturor

për qytetin e Gjilanit në vlerë rreth 27 milionë euro. Lajmin e ka bërë me dije kryetari Alban Hyseni. “Nënshkruam projektin më të madh infrastrukturor në

historinë e qytetit, me vlerë rreth 27 milionë euro, me zëvendësministrin Hysen Durmishi. Qarkorja e re e qytetit ka gjatësi rreth 20 km, 4 korsi që do të lidhin të gjitha

rrugët magjistrale. Gjilani me qeverisje të ndershme e plot dinjitet tashmë ka kthyer vëmendjen meritorë”, ka shkruar Hyseni në “Facebook”.



Dy të plagosur nga shpërthimi i një granate dore në veri

MITROVICË, 16 JANAR - Nga shpërthimi i një granate dore në orët e vona të së hënës në Mitrovicë të Veriut janë plagosur dy persona.

Zëvendësdrejtori i Policisë për rajonin e Veriut, Veton Elshani, tha për “Radion Evropa e Lirë” se njëri nga të plagosurit është në gjendje më të rëndë shëndetësore dhe po trajtohet në spitalin në Mitrovicë të Veriut. Por, sipas tij ai është jashtë rrezikut për jetë.

Ndërkaq, personi tjetër është plagosur lehtë. “Nuk kemi arsye të besojmë se ky rast ka lidhje me çështje etnike”, tha Elshani.

Drejtori i Qendrës Klinike Spitalore në Mitrovicën e Veriut, Zllatan Elek, tha se një pacient, me inicialet N.V, gjendet në reanimacion, për shkak të lëndimeve të pësura nga një mjet plasës.

Por, edhe sikurse Policia, edhe Ellek tha se ai është jashtë rrezikut për jetë. “Të gjitha procedurat diagnostike dhe konsultimet me specialistë të tjerë janë ende duke u bërë. Gjatë ditës do të vendoset nëse ai do të vazhdojë trajtimin në këtë qendër, apo do të ketë nevojë për



trajtim në një institucion tjetër shëndetësor terciar në nivel të Serbisë”, tha Ellek për “Radion Evropa e Lirë”.

Ai shtoi se i plagosuri i dytë është dashur të mbahej i shtruar në ortopedi, por ai është larguar

nga spitali me vetëdëshirë.

Nga Policia thanë se ngjarja ndodhi në orën 23:50 të 15 janarit, kur tre persona, të nacionalitetit serb - dy prej të cilëve u plagosën dolën nga një lokal i njohur si “Bishevac” në

Mitrovicë të Veriut dhe me të dalë, një veturë u është afruar, prej së cilës është hedhur një granatë dore.

Nga shpërthimi janë dëmtuar edhe shtatë vetura që gjendeshin aty pranë, ndërkaq

autoritetet e sigurisë thanë se po merren për zbardhjen e këtij rasti.

Edhe në të kaluarën në Mitrovicë të Veriut - komunë e banuar me shumicë serbe - ka pasur incidente me mjete plasëse.

Ismet Krasniqi emërohet këshilltar i presidentes Osmani



PRISHTINË, 16 JANAR - Ismet Krasniqi, ish-sekretar i përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës për afro 17 vite, është emëruar këshilltar i presidentes Vjosa Osmani. Përgjatë angazhimit të tij, Krasniqi është shquar për përkushtim e profesionalizëm.

Këshilltari Krasniqi ka qenë mbështetës profesional i të gjitha proceseve me rëndësi të veçantë për vendin tonë, duke filluar nga Pakoja e ish-presidentit Ahtisari, përgatitja profesionale e teknike për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, përmbyllja e mbikëqyrjes së Pavarësisë,

angazhimi teknik në përcjelljen dhe kompletimin e dokumentacionit për nevojat e delegacionit tonë në GJND, si dhe përgatitjet për amendamentet kushtetuese. Një kontribut të veçantë Krasniqi e ka dhënë edhe në sigurimin e prezencës së komunitetit të donatorëve në Kuvend dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile në punën e Kuvendit.

Presidentja Osmani i ka urre mirëseardhje Krasniqit dhe ka theksuar se angazhimi i tij është vlerë e shtuar për Kabinetin, ngase ai bart pas vetes një përvojë të gjatë institucionale e profesionale.

Smajl Latifi përmbush edhe një zotim publik, 500 euro për çdo lindje

RAHOVEC, 16 JANAR - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar vendimin e parë të

subvencionimit të lindjeve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) “Dr. Fahredin Hoti” në

Rahovec. “Nga janari i këtij viti, çdo lindje në Repartin e Maternitetit të QKMF-së “Dr. Fahredin Hoti”, do të

mbështetet me 500 euro nga Komuna e Rahovecit”, ka njoftuar Latifi në “Facebook”.



KDI-ja: Trendi në rritje i shkeljes së të drejtave të punëtorëve edhe në sektorin publik

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 JANAR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur konferencë për medie të martën, ku u shpalosën detaje lidhur me praktikat selektive dhe shkeljen e të drejtave të punës edhe në sektorin publik, duke u fokusuar veçanërisht në një rast në Komunën e Prishtinës që ka rezultuar në shkelje e të drejtave të punëtorëve të institucioneve arsimore në këtë komunë.

Albesa Humolli, përfaqësuese e KDI-së, ka theksuar se viteve të fundit është një rritje alarmante e raportimeve të shkeljeve nga marrëdhënia e punës dhe parregullsive në vendin e punës. “Raportimet e qytetarëve që KDI-ALAC pranon në baza ditore paraqesin një pamje të zymtë të sektorit publik dhe privat në Kosovë, ku mohimi i të drejtave të punëtorëve po bëhet gjithnjë e më i përhapur. Këto raportime zakonisht përmbajnë shkelje thelbësore, të tilla si mungesa e kontratës formale të punës, mospagimi i kontributeve pensionale dhe refuzimi i pushimit vjetor apo mjekësor me pagesë apo vonesat në pagë. Këto raportime të shpeshta dhe shqetësuese jo vetëm që nënvizojnë problemet e shumta me të drejtat e punëtorëve, madje edhe në nivelin e tyre më elementar por janë edhe indikator se ku po çalon lufta kundër korrupsionit në vend dhe cilat janë sektorët më të prekur nga korrupsioni.

Ndërsa shumica e shkeljeve të të drejtave të punës raportohen në sektorin privat, KDI-ALAC ka shënuar një rritje të numrit të rasteve të shkeljeve nga marrëdhënia e punës brenda sektorit publik, kështu duke e sfiduar perceptimin e përgjithshëm se punësimi në sektorin publik është më i rregulluar dhe se të drejtat e punonjësve në këtë sektor janë më të mbrojtura”, ka thënë ajo, duke shtuar se ndryshe nga sektori privat, ku shkeljet shpesh ndodhin pas punësimit, sektori publik sheh shkelje më së shumti gjatë procesit të punësimit, duke përfshirë edhe



rekrutimin. “Sidoqoftë, kohëve të fundit janë shpeshtuar rastet kur punonjësit e institucioneve publike paraqiten në KDI-ALAC me raportime mbi shkeljet e së drejtave të tyre në vendin e punës”, ka theksuar Humolli.

Në shtator të vitit të kaluar, KDI ka pranuar një raportim nga Edona Berisha, mësimitdhënëse në SHML “Ali Sokoli” në Prishtinë, për mohim të së drejtës për pushim mjekësor. Institucioni arsimor në fjalë i kishte hequr asaj mëditjen për shkak të mungesës njëditore në vendin e punës për shkaqe shëndetësore, duke theksuar në vendim që si vërtetim i vlefshëm është vetëm ai i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, e jo edhe vërtetimi i lëshuar nga qendrat tjera të mjekësisë familjare në Komunën e Prishtinës.

KDI-ja kishte asistuar Berishën që të ankimojë vendimin në fjalë tek Drejtoria e Arsimit në

Komunën e Prishtinës. DKK-ja kishte refuzuar ankesën, duke cituar një Qarkore njoftuese (03-646-2023) të shtatorit 2023, sipas së cilës njihen si valide vetëm shenjat mjekësore dhe pushimet mjekësore të lëshuara nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kjo qarkore përcakton kufizime për mësimitdhënësit sa i përket marrjes së pushimit mjekësor e kështu tejkalon kërkesat ligjore të përcaktuara nga ligji i punës në fuqi, si dhe të vetë kontratave të punës të nënshkruara mes mësimitdhënësve dhe komunës.

Ndonëse pa mbështetje adekuate ligjore në aktet në fuqi, KDI-ALAC ka zbuluar që kjo qarkore ka krijuar polemika si dhe praktika kontroverse e jokonsistente edhe në implementim.

Si rrjedhojë, KDI-ja përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, ka marrë konfirmim zyrtar nga Komuna e

Prishtinës që arkorja në fjalë interpretohet në frymën që valide konsiderohen të gjitha vërtetimet e lëshuara nga të gjitha institucionet publike shëndetësore, përfshirë edhe qendrat e zakonshme të mjekësisë familjare.

Sipas zyrtarëve të KDI-së, ky rast, por edhe të tjerë të kësaj natyre, flasin për praktika selektive të institucioneve publike në raport me administrimin e marrëdhënies së punësimit dhe respektimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës në sektorin publik.

Sipas zyrtarëve të KDI-së, trajtimi diskriminues i Berishë, flet për tendencën e institucioneve publike për zbatim të gabuar të akteve në fuqi, moskomunikim brenda niveleve të ndryshme të vendimmarrjes në institucione publike, si dhe ekzistimin e dispozitave të paqarta - që si faktorë mund të qojnë në shkelje

të të drejtave bazike në punë.

Tutje sipas tyre, rasti i Berishës është më shumë se një gabim burokratikë; në fakt është shembulli i shkeljeve sistematike dhe të rrënjësura thellë të të drejtave të punës, e që fatkeqësisht prekin edhe sektorin publik në vend. “Ky rast nuk është një incident i izoluar, por një simptomë e një problemi më të madh e më të përhapur e që nënvizon një kulturë ku ngatërresat burokratike dhe keqinterpretimet e politikave jo vetëm që mbysin të drejtat e punëtorëve, por gjithashtu gërryejnë edhe besimin e qytetarëve në institucionet publike”, thonë zyrtarët e KDI-së.

Kjo situatë kërkon një përgjigje urgjente dhe të fuqishme, jo vetëm në drejtim të rishikimit dhe zbatimit të politikave, por edhe në nxitjen e kulturës së llogaridhënies dhe transparencës brenda institucioneve publike në vend.

Gjendja e rëndë e punëtorëve në Kosovë, duke luftuar kundër një sistemi të rrënjësuar që shpesh shpërfill apo edhe shtyp të drejtat e tyre, kërkon veprim të menjëhershëm dhe vendimtar.

KDI-ALAC u kanë bërë thirrje të gjithë të punësuarve të raportojnë rastet kur ata kanë qenë subjekte të praktika të padrejta të institucioneve ose kanë qenë viktimë e ndonjë formë të shkeljes së të drejtave të punës. Së bashku, ne mund të punojmë drejt krijimit të një mjedisi në vendin e punës ku çdo punonjës trajtohet me dinjitet dhe të drejtat e tyre respektohen plotësisht.

Në kuadër të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) që nga viti 2015 funksionon Qendra për Avokim dhe Ndihmë Juridike Falas (ALAC), qendër kjo që ofron këshilla ligjore dhe asistencë juridike falas për qytetarët, sinjalizuesit dhe viktimat e korrupsionit. Përmes kësaj qendre rreth 1500 qytetarë kanë raportuar në lidhje me parregullsitë dhe keqpërdorimet në vendin e tyre të punës, në institucionet publike apo private, në gjykata apo në organet e tjera.

Pjesëtarët e FSK-së dhe personeli i Ministrisë së Mbrojtjes do të udhëtojnë pa viza për në Mbretërinë e Bashkuar

PRISHTINË, 16 JANAR - Nënkoloneli Steve Forrest, këshilltar bilateral në Ministrinë e Mbrojtjes në një takim me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka njoftuar për vendimin e autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar për udhëtim pa viza për personelin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës që zhvillojnë aktivitete ushtarake

dhe zyrtare në Mbretërinë e Bashkuar.

Ministria e Mbrojtjes ka theksuar se ky vendim është rezultat i bashkëpunimit të thelluar në fushën e mbrojtjes, mirëbesimit të krijuar ndër vite dhe angazhimit të Republikës së Kosovës në aktivitetet e mbrojtjes që udhëhiqen nga Mbretëria e Bashkuar.

“Mbretëria e Bashkuar në vazhdimësi ka luajtur rol kyç në procesin e shtet ndërtimit në përgjithësi dhe fuqizimin e kapaciteteve të mbrojtjes të vendit tonë, në veçanti. Kjo është edhe një dëshmi për kredibilitetin që Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës gëzon te partnerët tanë”, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.



Ministri Peci vlerëson bashkëpunimin e Austrisë në fushën e bujqësisë

PRISHTINË, 16 JANAR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, George Schnetzer, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e përgjithshme në sektorin e bujqësisë, si dhe për projektet zhvillimore të MBPZhR-së për këtë vit. Gjatë këtij takimi, ministri Peci e ka njoftuar homologun e tij austriak edhe me prioritetet e politikave bujqësore, duke theksuar se këto politika janë avancuar viteve të fundit, e në

të cilat përfshihet edhe thellimi i bashkëpunimit me shtetet evropiane. Me këtë rast, ministri Peci e ka vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm mes të Kosovës dhe Austrisë në fushën e bujqësisë përmes projekteve të shumta zhvillimore për fuqizimin e mëtejme të sektorit. “Në këtë takim diskutuam për vazhdimin e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë, si dhe për mundësitë e zgjerimit të këtij bashkëpunimi edhe në sektorë të tjerë të bujqësisë. Për të

konkretizuar këtë bashkëpunim gjatë këtij viti, u pajtuam që të ndërmarrim edhe hapa dhe veprime konkrete, të cilat do t'i kontribuojnë zhvillimit dhe avancimit të mëtejme të sektorit të bujqësisë në vend”, tha ministri Peci. Nga ana e tij, ambasadori i Austrisë në Kosovë, George Schnetzer, ritheksoi edhe njëherë gatishmërinë e shtetit të tij për thellimin e bashkëpunimit mes të dyja vendeve, me qëllim të zhvillimit të këtij sektori.



Kurti në Cyrih, merr pjesë në hapjen e salloneve të mobilieve të prodhuara në Kosovë



Prishtinë, 16 janar- Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në ceremoninë hapëse të salloneve të mobilieve dhe prodhimeve të drurit të prodhuara në Kosovë, të kompanive Mobile Dekor, Shehu L.L.C dhe AMW Interior, biznese këto nga diaspora jonë në Zvicër. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti tha se kjo është dëshmi e qartë e potencialit të cilësive që vijnë nga prodhimet tona, dhe një dritare drejt tregjeve botërore për mobiliat “Made in Kosova”. “Ne në

Kosovë, kemi bërë përpertime të jashtëzakonshme në demokraci dhe sundim të ligjit në këto tre vitet e fundit, dhe kjo padyshim që ka frymuar një zhvillim të shpejtë edhe të sektorit privat. Me një renditje nga Freedom House si vendi i tretë në botë për përpasim në demokraci, dhe duke i shtuar rezultatet më të mira në vendin tonë prej se jemi çliruar, kemi dëshmuar angazhimin tonë i cili konsiston në kombinimin e zhvillimit ekonomik me progres

demokratik”, shtoi kryeministri. Ai theksoi se edhe përmes luftimit të korrupsionit, kemi ndihmuar në krijimin e një shoqërie më të drejtë e më të barabartë e që ka sjellë rritje ekonomike, e sidomos rritje të eksportit dhe të investimeve të huaja. “Është një dëshmi e fortë se demokracia dhe sundimi i ligjit janë çelësi për prosperitetin ekonomik. Kështu, për më pak se tri vjet, Republika e Kosovës ka më shumë eksporte, sesa për më shumë se 6 vjet të

periudhës paraprahe. Kjo tregon se sa dinamik është sektori privat në Kosovë”, u shpreh kryeministri, duke shtuar se kompanitë tona jo vetëm që prodhojnë mallra me cilësi, por ato janë edhe të afta edhe të qëndrojnë në tregjet ndërkombëtare. “E kjo sjell rritje ekonomike, krijon vende pune, por gjithashtu e përmirëson dhe imazhin dhe reputacionin e shtetit tonë në botë”, tha Kurti. Ai tha se në këtë udhëtim drejt suksesit në tregjet

ndërkombëtare, është thelbësore që kompanitë tona të kenë qasje në burimet e duhura dhe ky showroom këtu në Cyrih është veçse fillimi. “Së bashku, me këto kompani tona e shumë e shumë të tjera, me mbështetjen e qeverisë, dhe me partneritetin tonë me organizata si USAID, ne mund të ndërtojmë një të ardhme më të ndritur për Kosovën brenda shtetit e në skenën ndërkombëtare”, shprehet kryeministri.

Shala: Paga minimale prej 264 eurove e pamjaftueshme, institucionet duhet të shqetësohen

Prishtinë, 16 janar- Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka thënë se si parti kanë ngritur shqetësimin e tyre shumë më herët sa i përket Ligjit për pagën minimale. Ai ka deklaruar se nuk pajtohen me pagën minimale prej 264 euro. “Ne kemi ngritur shqetësimet tona shumë më herët pasi kjo rritje është e pamjaftueshme dhe nuk jemi

pajtuar me këtë pagë që e ka propozuar qeveria, përkundër asaj që jemi në një situatë krejt të re ekonomike ku kemi një shkallë të lartë të inflacionit. Ne kemi shprehur mospajtimet tona dhe nuk pajtohemi me këtë pagë minimale çfarë sot realisht e kanë qytetarët e vendit”, është shprehur deputeti Shala për “Front Online”. Por, pavarësisht kësaj ka deklaruar se janë duke e

pritur vendimin e Kushtetueses. E, në rast se Kushtetuesja merr vendim në favor të ligjit, Shala ka thënë se do të shohin nisma të tjera se si të ngritët paga minimale. “Definitivisht 264 euro janë të pamjaftueshme dhe ne po presim vendimin e gjykatës dhe të shohim hapat tjerë apo nismat tjera ligjore apo parlamentare se si t'i përgjigjemi situatës”, ka thënë Shala.



Pikniku i guximshëm që ndihmoi në çlirimin e Evropës nga zgjedha sovjetike



19 gusht 1989: Gjermanolindorët befasojnë rojet kufitare hungareze dhe nxitojnë për të kaluar në Austri (foto: Votava/AP)

Nga: Katja HOYER /
The Telegraph

“Q... shekullin XX”, ishte slogani prapa rok-grupit hungarez Beatrice. Një veturë Trabant e Gjermanisë Lindore varej mbi skenë. Ishte gushti i vitit 2019 dhe grupi Beatrice – që ishte kritikë e zëshme kundër komunizmit gjatë Luftës së Ftohtë – po e jepte një koncert për ta shënuar ngjarjen që ndihmoi në çlirimin e Evropës Lindore nga zgjedha sovjetike: Piknikun Pan-Evropian.

Tridhjetë vjet më parë, më 19 gusht 1989, diçka e jashtëzakonshme kishte ndodhur. Perdja e Hekurt u hoq gjatë disa orëve monumentale – në një piknik të mbajtur nga reformatorët hungarezë në kufirin Austri-Hungari. Mes muzikës, birrës dhe gullashit, qindra vetë dolën në Perëndim, teksa era e ndryshimit po frynte në Lindje. Kur sovjetikët nuk reagueshan, disa javë më vonë Hungaria i hapi kufijtë e vet – përgjithmonë. Më 9 nëntor ra Muri i Berlinit dhe bashkë me të edhe shtylla e fundit që mbështeti komunizmin evropian.

Derisa janë bërë emblematike ngjarjet në Berlin në vjeshtën e vitit 1989, Pikniku Pan-Evropian është më pak i njohur – por, Pikniku [The Picnic] i Matthew Longos tenton ta ndryshojë këtë. Si asistent-profesor i Shkencave Politike në Universitetin e Leidenit, magjepsja e Longos me Perden e Hekurt është si ndarje e sistemeve. Libri i tij i mëparshëm, Politika e kufijve [The

Politics of Borders, 2018,] argumentoi se kufijtë vetvetiu “janë institucione politike” dhe se kanë pasoja të mëdha, ndaj ku ka temë më të mirë për ta vërtetuar çështjen sesa rënia e atij që ndau botën në pjesën më të madhe të shekullit XX?

Ende është i diskutueshëm roli që luajti Pikniku Pan-Evropian në rënien e Perdes së Hekurt. Është fakt se gati 700 gjermano-lindorë u arratisën në Gjermaninë Perëndimore nëpërmjet Austrisë – eksodi më i madh që nga ngritja e Murit të Berlinit në vitin 1961. Fletëpalosjet i kishin informuar ata për një demonstratë paqësore në Hungari, në të cilën kufiri i saj me Austrinë do të hapej simbolikisht për tri orë. Shumëkush e kuptoi aludimin dhe u futën në Hungari me viza pushimi.

Është gjithashtu fakt se ngjarja nuk ishte spontane. Ideja për ta lejuar kalimin e një grupi të madh të njerëzve erdhi pjesërisht nga Otto von Habsburgu, nga princi i fundit i kurorës së Perandorisë së vdekur Austro-Hungareze, së bashku me reformatorët hungarezë dhe grupet opozitare. U sanksionua nga kryeministri Miklós Németh, i cili tashmë kishte filluar të zbuste kontrollat e sigurisë në kufi. Gazetarët qëndruan gati për të bërë fotografi. Pikniku ishte provë: si do të reagojë Bashkimi Sovjetik? Kur Moska nuk bëri asgjë, kjo e përshpejtoi rrugën drejt reformave. Longo e mbulon piknikun në nivel sipërfaqësor, duke evokuar në detaje

ngjarjet më dramatike: “Një bandë e frymorëve shpërtheu nëpër fushë. Gullashi i gatuar në tenxheret gjigante mbi flakën e hapur; birrat dhe verërat ishin aty për t’u konsumuar. Njerëzit vallëzuan rreth zjarrit ... ‘Për të gjithë miqtë tanë në Evropë!’ – bërtiti Ferenci [Mészáros, një nga organizatorët]. ‘E vetmja mundësi për paqen në mbarë botën ... është prishja e telave me gjemba dhe e barrierave kulturore’”.

Duke udhëtuar në Gjermani dhe në Hungari për katër vjet, Longo kreu intervista me gjermano-lindorët e zakonshëm që u larguan më 19 gusht 1989, ndërsa foli me shumë nga figurat kryesore në Hungari që u përfshinë në organizimin e piknikut. Anekdodat dhe përshkrimet nga këto takime janë ndërthurur përmes rrëfimit historik, duke ofruar pasqyrën se sa shumë rëndësi ka sot kjo histori.


Németh, kryeministri i fundit komunist i Hungarisë, duke qenë “i mërzhitur” kur autori atë e takoi në vitin 2019. Një njeri me “integritet dhe qetësi”, Némethi refuzoi të merrte pjesë në 30-vjetorin e Piknikut sepse paneli i tij titullohej “Zhvillimi dhe kolapsi”. Për të, asnjë nga termat nuk përfshinte gjithë punën që ai kishte bërë për të mundësuar ndryshimet paqësore në Hungari. Sipas tij, nuk kishte asnjë “zhvillim”, pasi qeveria e tij e kishte lejuar hapjen e kufijve, dhe nuk kishte “kolaps” aksidental të komunizmit në Hungari, por shpërbërje të kujdesshme nën udhëheqjen e tij.

Dy akterët e tjerë të vitit 1989, megjithatë

u shfaqën në përvjetorin e vitit 2019, të dy si udhëheqës të vendeve që ishin në tranzicion të shpejtë dikur: Angela Merkel dhe Viktor Orbán. Merkel ishte në Berlin kur ra Muri dhe menjëherë filloi një karrierë në ngritje që do ta çonte në krye të politikës gjermane. Orbáni ishte 26-vjeçar kur premtoi të “varroste komunizmin” – në një fjalim të mbajtur në vitin 1989 për rehabilitimin dhe rivarrimin e ish-kryeministrit Imre Nagy, i cili u ekzekutua për udhëheqjen e Revolucionit Hungarez të vitit 1956. Në përvjetorin e Piknikut, Orbáni foli për sovranitetin kombëtar, ndërsa Merkeli foli për refugjatët. “Politika: si gjithmonë”, përfundon Longo.

Si politolog, Longo nuk është plotësisht imun ndaj politizimit të vetë historisë, por është jashtëzakonisht i sinqertë për këtë. Lexuesit njihen me pikëpamjet e autorit për kufijtë sot. Politikën e Orbánit për ta reduktuar emigracionin e paligjshëm në Evropë, për shembull në vazhden e krizës së refugjatëve të vitit 2015, përshkruhen si kthesë “që shkakton goditje kamxhiku”: “Hungaria, vendi që shkatërroi muret, tani po i ndërton ato”.

Teksa herë pas here nuanca sakrifkohet në altarin e efektit narrativ, zinxhiri i ngjarjeve të vitit 1989 dhe konteksti historik theksohen qartë. Rrëfimi është i mbushur me komentet dhe anekdotat e Longos nga udhëtimet, duke e bërë Piknikun një rrëfim thellësisht personal të një momenti magjepsës historik të historisë së Luftës së Ftohtë. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Xhaka: Jam si vera e kuqe, gjithmonë e më i mirë

LEVERKUSEN, 16 JANAR - Granit Xhaka është zgjedhur lojtari i vitit në Zvicër. Kjo është hera e tretë për mesfushorin e Bayer Leverkusen që e rrëmben një çmim të tillë, duke konfirmuar kështu edhe momentin e mirë që po kalon te skuadra gjermane. Pas fitimit të trofeut, ish-i i Arsenalit theksoi se është shumë krenar dhe i lumtur që vazhdon të vlerësohet në Zvicër, ndërsa thekson se për të nuk ka qenë aspak e lehtë. Gjithashtu nuk nguron të shprehet se është si “Vera e kuqe, gjithmonë e më i mirë”. “Krenari dhe kënaqësi. Është shpërblimi për punën e vështirë të përditshme. Si

futbollist ke edhe ditë të zeza. Nëse, si unë në Londër, ju shajnë mbi 60,000 njerëz në stadium. Sapo hyra në dhomën e zhveshjes ditën e parë, ndjeva: Ky është një ekip i mirë, një shpirt i mirë ekipor. Ne gjithashtu kemi një trajner fantastik në Xabi Alonso. Edhe pse gruaja ime është nga Dyseldorfi, ajo ishte kundër që ne të largoheshim nga Londra. Sigurisht, kjo i bëri gjërat edhe më të vështira. Gjithsesi, nuk është e lehtë të largohesh nga ky qytet i madh pas shtatë vitesh. Leverkusen më ofroi një kontratë afatgjatë. Dhe nëse gjërat vazhdojnë të shkojnë siç kanë



shkuar, padyshim që ishte vendimi i duhur. Në Angli kam mësuar shumë përsa i përket

mentalitetit. Unë jam 31 vjeç tani, jo më i ri. Por unë jam si vera e kuqe – gjithmonë më mirë”, ka

thënë Xhaka. I pyetur se a mund të shpresojnë në rikthimin e Xhakës në Basel mund të në fund të karrierës, futbollisti me prejardhje shqiptare: “Kur të mbarojë kontrata ime me Leverkusenin, do të jem gati 36 vjeç. Le të shohim nëse kam akoma dëshirë të luaj futboll. Por të luaj sërish bashkë me Taulantin me fanellën e Baselit është një ëndërr. Dhe deri më tani pothuajse të gjitha ëndrrat e mia janë realizuar. Titullin e kampionit në Gjermani apo Kampionatin Evropian? Eh, pyetje e vështirë! Le ta themi kështu: Nëse do të kisha një nga titujt me siguri, do të firmosja menjëherë”.

Dymbëdhjetë gjimnaste nga Kosovës po trajnohen në Turqi



PRISHTINË, 16 JANAR - Dymbëdhjetë gjimnaste nga Kosova të shoqëruar nga trajnerët e të mbështetur nga Federata e Gjimnastikës së Kosovës, po qëndrojnë në Turqi. Atje janë vendosur në kampin stërvitor për tu përgatitur për garat e radhës dhe për të marrë eksperiencën të reja nga trajnerët ndërkombëtarë. Siç thuhet në njoftimin e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, gjimnasteve nga Kosova dhe trajnerëve, do të janë pjesë e trajnimeve në kampin stërvitor në

Turqi është edhe trajneri i kombëtares turke Cem Volkan Yavas. “Bashkëpunimi me trajnerin turk, shton një dimension të ri në këtë kamp trajnimi, duke sjellë një ndërthurje të njohurive dhe teknikave ndërkombëtare për sportistët kosovarë. Dita e pare në kampin trajnues në Turqi ka filluar, më 14 janar 2024”, thuhet në njoftimin e FGJK-së. Ky kamp i organizuar nga Federata e Gjimnastikës së Kosovës do të zgjasë deri më 21 janar 2024. Dymbëdhjetë gjimnaste nga ekipi i

Kosovës do të trajnohen për shtatë ditë në këtë palestër që i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për stërvitje. “Arsyeja pse jemi këtu është për të përmirësuar aftësitë tona në fushën e gjimnastikës dhe për të përfaqësuar me krenari vendin tonë në ngjarjet ndërkombëtare të radhës. Ky kamp stërvitor është një mundësi e jashtëzakonshme për sportistët e gjimnastikës së Kosovës, për të ndërtuar më shumë njohuri dhe përvojë në këtë fushë”, thuhet ndër të tjera në njoftimin e FGJK-së.

Frashëri fiton gjyqin në CAS me skuadrën arabe, tani ka oferta nga Kosova dhe Shqipëria

PRISHTINË, 16 JANAR - Stivi Frashëri pritet të rikthehet në fushat e blerta pas gjashtë muajve pauzë. Portieri shqiptar ishte larguar nga Ballkani në verë dhe kishte gjetur marrëveshje me skuadrën nga Liga e Parë e Arabisë Saudite, Jeddah. Megjithatë Frashëri nuk ka luajtur fare për këtë skuadër, pasi nuk mundi të udhëtojë shkaku i vizës së punës në Arabinë Saudite dhe drejtuesit e Jeddah regjistruan një futbollist tjetër të huaj. Frashëri kishte nënshkruar kontratë dhe tani ka dalë i lirë pasi ka fituar gjyqin ndaj skuadrës arabe ku ka fituar edhe një shumë të majme të parave nga kontrata që kishte me këtë klub. 33-vjeçari ka treguar për “Telegrafin” se tani është një lojtar i

lirë pasi fitoi gjyqin në CAS me Jeddah Club. “Unë tani jam një portier i lirë, pasi kam fituar gjyqin në CAS me Jeddah Club në Arabinë Saudite. Sot klubi ka pranuar të bëjë pagesën e plotë për moskorrektësinë e tyre dhe tani nuk kam asgjë me këtë skuadër”, ka deklaruar Frashëri. Frashëri ka falënderuar menaxherin e tij Faisal Al-Jomail si dhe avokatin e tij Mawuli Kwaku që bënë një punë të shkëlqyer në gjyqin përballë Jeddah Club. “Dua të falënderoj menaxherin dhe mikun tim Faisal si dhe avokatin Mawuli Kwaku si dhe agjensin e tij AVORGAH Director of M.I.G Mak International Group, a Sports Management për gjithçka që bënë

në këtë betejë ligjore”, deklaroi portieri i njohur shqiptar. Frashëri ka një karrierë të bujshme pasi ka luajtur për Aris Selanikun në Greqi, derisa karrierë ka bërë kryesisht në skuadrat shqiptare si Bylis, Tirana, Flamurtari, Kukësi e Teuta e Durrësit. Ai ka paralajmëruar rikthimin në futboll gjatë afatit kalimtar të janarit, ku shumë klube janë vënë pas tij duke marrë parasysh që bëhet fjalë për një portier me shumë cilësi dhe si një nga më të mirët në tregun shqiptar. “Nga sot do shqyrtoj edhe mundësitë që më janë ofruar nga Prishtina në Kosovë apo Dinamo City në Shqipëri. Gjithashtu ka shumë skuadra që më kanë kontaktuar, por nga sot do t'i

shqyrtoj të gjitha ofertat pasi tani jam një portier i lirë dhe pa obligime ndaj asnjë skuadre”, u shpreh portieri shqiptar për

“Telegrafin”. Frashëri ishte pjesë e Ballkanit në Kosovë në dy vitet e fundit ku fitoi dy tituj kampioni me skuadrën suharekase.



Deschamps: PSG-ja herët e vonë do ta fitojë Ligën e Kampionëve

PARIS, 16 JANAR - Trofeu i shumëkërkuar që mungon në Paris mbetet ai i Ligës së Kampionëve PSG i ka shkuar afër disa herë, por nuk ia ka dalë kurrë. Një situatë, një rreth vicioz, por që duket se do të thyhet sipas trajnerit të Francës,

Didier Deschamps. “Herët ose vonë, PSG-ja do të arrijë ta fitojë Ligën e Kampionëve”. Me këto fjalë trajneri francez ka shkaktuar bujë në atdhe. Sepse Deschamps ka folur me një lehtësi absurde dhe një qetësi çarmatosëse: nuk ka asnjë

dyshim se këtë vit ose tjetrin PSG-ja do ta fitojë trofeun e shumëkërkuar. Këto kanë qenë deklaratat e bëra nga ai për Telefoot: “Çdo vit mund të jetë ai i duhuri për Ligën e Kampionëve ose ai i gabuar, nuk ka rëndësi. Në fund do të vijë në

një moment ose një tjetër, dhe kjo është ajo që uroj për PSG, edhe pse te Marseille nuk do të jenë të gëzuar. “Është shumë e rëndësishme për futbollin francez që PSG-ja të fitojë Ligën e Kampionëve”, ka përfunduar Deschamps.

Perez paralajmëron Verstappenin: Koha për t'u shpallur kampion

Guadalajara, 16 janar - Si të gjithë pilotët e Formula 1 edhe ai meksikan Sergio Perez kërkon të mposhtë shokun e tij të skuadrës së Red Bull, Max Verstappen. Meksikani është renditur i dyti në klasifikimin për pilotë, ndaj kërkon që t'i vërë stërkembësin

Verstappen. "Sigurisht që ka shumë gjëra që mund të mësoj nga Max. Madje kam pikën më të mirë të referimit aktualisht në Formula 1. Ai ka qenë mjaft kompetitiv vjet, ndërsa unë humba disi ritmin pas garave të mira që bëra në start", ka thënë

Perez. "Nuk ka asgjë të keqe ta shoh atë që bën, si e bën dhe të përpiqem të përmirësohem. Kështu shoh atë që nuk shkon si duhet tek unë, atë që ai bën ndryshe etj. Ne kemi pasur një marrëdhënie të hapur bashkë, që ka funksionuar mirë", u shpreh

meksikani. "Nuk e mohoj që fitimi i titullit kampion është objektivi kryesor për mua, pasi vendi i dytë nuk më mjafton më. Dua të përmirësohem dhe jam i vetëdijshëm për sfidën që më pret me Max. Dua të shfrytëzoj këtë periudhë për të qenë në



formë kur të nisë kampionat, për të qenë sa më konstant", ka deklaruar Perez.

Shkarkohet Mourinho, Roma emëron trajner De Rossin

ROMË, 16 JANAR - AS Roma e ka shkarkuar trajnerin portugez, Jose Mourinho. Rezultatet e dobëta i kanë kushtuar "The Special One" postin e trajnerit të klubit kryeqytetas. Klubi italian e ka falënderuar trajnerin portugez për kontributin e dhënë në skuadër, derisa ka vlerësuar se ndryshimi ishte i domosdoshëm. "AS Roma njofton se Jose Mourinho dhe bashkëpunëtorët e tij teknikë do të largohen nga klubi me efekt të menjëhershëm. Mourinho u shpall si trajneri i gjashtëdhjetë në historinë e Romës në maj të vitit 2021. Ai e drejtoi skuadrën drejt triumfit të Ligës e Konferencës në Tiranë më 25 maj 2022 dhe në finalen e Ligës së Evropës në Budapest sezonin e kaluar. Falënderojmë Jose Mourinho në emër të të gjithë Romës për pasionin dhe përkushtimin që ka treguar që nga ardhja e tij në kryeqytet. Ne gjithmonë do të kemi kujtime të shkëlqyera nga administrimi i tij, por ne besojmë se, në interesin më të mirë të klubit, ndryshim i menjëhershëm është i



nevojshëm. I urojmë Joses dhe bashkëpunëtorëve të tij më të mirën për të ardhmen", thuhet në njoftimin e skuadrës së Romës. Klubi kryeqytetas e ka gjetur menjëherë zëvendësuesin e Jose Mourinhos. Bëhet fjalë për Daniele De Rossi, i cili rikthehet në kryeqytet, në shtëpinë e tij, këtë herë me një rol të ri. De Rossi ka firmos një kontratë deri më 30 qershor 2024. "AS Roma ka

kënaqësinë të njoftojë se Daniele De Rossi është emëruar si menaxher i ri teknik i ekipit të parë deri më 30 qershor 2024. Pas 18 vitesh si futbollist i verdhekuqve, De Rossi do të rikthehet në rolin e trajnerit dhe do të debutojë në stolin tonë në ndeshjen e kampionatit kundër Veronës pasditen e së shtunës në "Olimpico", thuhet në njoftimin e skuadrës romake.

Golden State në krizë, Lakersat rikthehen te fitorja



LOS ANXHELOS, 16 JANAR - Vijon sezoni me luhatje i Lakersave, që ndeshjen e fundit e fituan me rezultat 112-105 ndaj Oklahomës. Dyshja Davis-James realizoi 52 pikë, duke bërë diferencën në fushë. Boston kryeson renditjen në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 105-96 në

fushën e Torontos. Të gjithë titullarët e Celtics realizuan mbi 10 pikë. Mes pretendentëve në Lindje është edhe Philadelphia, që mundi me shifrat 124-115 Houstonin. Ndeshje fantastike e Joel Embiid, autor i 41 pikëve dhe 10 rebound. Tjetër humbje për Golden State, që u

mund me shifrat 116-107 nga Memphis. Curry realizoi 26 pikë, por që s'mjaftuan para kolektivitetit të Memphis. Skuadra e Dallasit, falë 42 pikëve të Irving dhe 41 të Hardaway, mposhti me rezultat 125-120 New Orleans, një dyshe që shkëlqeu në fushë. Fiton edhe Clevelandi, që mposhti me rezultat 109-91 Chicagon, ndeshje ku u dallua Mitchell me 32 pikë. Utah Jazz mundi me shifrat 132-105 Indianan, ku protagonistë ishin Markkanen me 32 pikë e Sexton me 30.

REZULTATET

Philadelphia - Houston	124-115
Dallas - New Orleans	125-120
New York - Orlando	94-98
Washington - Detroit	117-129
Atlanta - San Antonio	109-99
Memphis - Golden State	116-107
Cleveland - Chicago	109-91
Brooklyn - Miami	95-96
Toronto - Boston	96-105
Utah Jazz - Indiana	132-105
Lakers - Oklahoma	112-105

SHKURT

Unitedi nuk është i interesuar për Benzeman

Karim Benzema dëshiron që të largohet nga Arabia Saudite vetëm gjashtë muaj pasi nënshkroi për Al-Ittihad, por Manchester United nuk janë të interesuar për të nënshkruar me ish-yllin e Real Madridit. Manchester United e ka përjashtuar mundësinë e nënshkrimit të francezit, edhe pse ata po vuajnë nga një krizë e golave. Mësohet se drejtuesit e Unitedit nuk kanë bërë ndonjë kontakt me përfaqësuesit e Benzemas, kryesisht për shkak të moshës së tij dhe pagës astronomike prej 86 milionë eurosh në sezon që përfiton në Arabi.

Matthausi kritikon FIFA-n: Nuk e meritonte Messi, por Haaland

Ka ngjallur shumë polemika triumfi i Lionel Messit për lojtarin më të mirë të FIFA-s 2023. Një vlerësim shumë polemizues duke qenë se afati kohor i referuar për votimin nisi nga 19 dhjetori 2022, duke përjashtuar kështu Kupën e Botës në Katar ku kishte parë protagonistin argjentinas. Lothar Matthaus, legjenda e futbollit gjerman dhe fitues i çmimit të FIFA World Player në 1991, foli për "Sky Deutschland". "Nëse shikoni sukseset e mëdha, atëherë të e meriton një lojtar nga Manchester City. Duhet të ishte Erling Haaland. Ai ka fituar tituj më të rëndësishëm me Cityn dhe përqindja e golave të tij është mbresëlënëse, diçka vendimtare për këtë vendim", ka thënë Matthaus. Messi përfundoi i barabartë në pikë me Haaland në votim, por çmimi shkoi për argjentinasin pasi FIFA në këtë rast përdor më pas vlerësimin e kapitenëve të kombëtareve, që ishin më shumë në favor të argjentinasit.

Trajneri i Tottenhamit: Jemi në garë për titull

Barazimi ndaj Manchester Unitedit në fundjavë në "Old Trafford", i ka dhënë shpresë Tottenham Hotspur për të vazhduar luftën për titullin e kampionit në Angli. "Spurs" janë në vendin e pestë me 40 pikë, pesë më pak se Liverpools që ka edhe një ndeshje më pak të zhvilluar dhe mbanë vendin e parë në tabelë. Megjithatë, përkundër diferencës së pikëve, trajneri i "Spurs", Ange Postecoglou ka thënë se ai vazhdon të ndjekë titullin e kampionit në Angli. "Me llogaritje ne jemi në garë për titull, apo jo. Nëse unë thosha jo, do të ktheheshit dhe do të thoshit 'Hajde, Ange'. Po ne jemi dhe deri në pikën ku ju nuk jeni, pse e refuzoni mundësinë? Kemi kaluar një periudhë vërtet të vështirë dhe po rrimë atje. Ne kemi kthyer rrugën tonë me kthetra. Paraqitjet tona në pjesën më të madhe kanë qenë mjaft të qëndrueshme. Por ne duhet ta përfundojmë sezonin më të fortë se pjesa e parë", ka deklaruar Postecoglou.

Skaloni ndryshon mendimin, qëndron tek Argjentina

Lionel Skaloni do të vijojë të jetë trajner i Argjentinës, të paktën deri në përfundimin e Kupës së Amerikës, kompeticion i cili do të zhvillohet nga data 20 qershor deri më datë 14 korrik. Ai arriti që "Albiceleste" të triumfonin në Botërorin "Katar 2022", por surprizoi kur pas një ndeshje ndaj Brazilit në nëntor, deklaroi se po mendonte tërheqjen nga kombëtarja pasi sipas tij ishte e vështirë për të vijuar në rrugën e sukseseve ndërsa shprehu edhe ambicien për të drejtuar një klub evropian. Megjithatë, pasi mori kohën e duhur dhe pas një takimi të fundit me krerët e Federatës, tekniku ka vendosur të qëndrojë. Argjentina do të tentojë të ruajë edhe statusin si Kampione e Amerikës, titull që e fitoi në vitin 2021 teksa mposhti në finale Brazilin.

Tucheli beson se Kane do të thyjë rekordin e Lewandowskit

Harry Kane i ka mahnitur të gjithë me performancën e tij këtë sezon me Bayern Munchen. Sulmuesi anglez ka realizuar deri më tani 22 gola në Bundesliga, kur është mbyllur vetëm gjysma e sezonit. Trajneri Tuchel ka

thurur elozhe për 30-vjeçarin duke u shprehur se Kane me këtë ecuri mund të thyjë edhe rekordin e vendosur nga Lewandowski në kohën që luante për Bayernin, kur realizoi 41 gola në kampionat gjatë një

sezonit. Ritmi i Kane është i kënaqshëm dhe nëse vijon kështu 40 golat do t'i arrijë se s'bën. Referuat rekordin të Lewas, Tuchel u shpreh: "Është në rrezik! Askush nuk e mendonte por ja që është në

rrezik. Na duhet edhe pak fat, duhet që edhe ekipi të vijojë kështu! Harry duhet të jetë në formë dhe më pas do të shohim se çfarë do të ndodhë". Kane u bashkua me Bayern në merkaton e verës nga skuadra e

Tottenhami për shifrën e 86 milionë sterlinave. Tucheli shton se Kane ka një personalitet të madh, është shumë i përlur por bëhet një peshkaqen në fushë, pasi do që të shënojë, do që të fitojë.

Bazuar ne ligjin e Punës Nr.03/L-212, neni 8 , LIGJI NR. 03/L-048, për menaxhimin financave publike dhe përgjegjësitë , neni 13 , Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ambienti”Sh.A .Pejë publikon këtë :

K O N K U R S

Për per plotësimin e venditë të lirë te punës

Pozita: Zyrtar i Prokurimit

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Të sigurojë se të gjitha kërkesat për prokurim, për punë, apo për shërbime këshillëdhënëse, janë të nënshkruara nga personat e autorizuar, si dhe të përgatisë materiale standarde dhe materiale të tjera për prokurim, varësisht nga metoda e prokurimit;
- Të përgatisë ftesat për ofertim/tenderim dhe t’i dërgojë ato për shpallje në mjetet e informimit; t’i shpërndajë ftesat për ofertim për blerje konkurruese; të pranojë fletëpagesat për material të tenderit dhe të regjistrojë në listën e hartuar për këtë qëllim të gjitha kompanitë që marrin materialin e tenderit; të pranojë të gjitha pyetjet, si dhe të japë përgjigje për të gjitha kompanitë me materialin e tenderit;
- Të marrë pjesë në komisione të hapjes së ofertave dhe të vlerësimit të ofertave;
- Të sigurojë mbajtjen e të dhënave të detajuara për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës; të kujdeset për veprimet dhe për vendimet e marra gjatë çdo faze të procesit; të sigurojë që komentet e të gjithë anëtarëve të shënohen dhe që anëtarët t’i nënshkruajnë ato komente;
- Të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm dhe të bëjë kompletimin e dokumentacionit për aprovim, pas mbarimit të procesit të vlerësimit;
- Të asistojë në mbikëqyrjen dhe në ekzekutimin (realizimin) e kontratave, duke raportuar për mosrealizimin e tyre; të bëjë kontrollimin e faturave në pajtim me kushtet e kontratës; të mbajë shënime për mallrat e pranuar dhe të nënshkruara nga nëpunësi i emëruar për pranimin e mallrave;
- Të përgatisë dokumentacionin për pagesë dhe ta dërgojë lëndën në Departamentin për Financa;
- Të hartojë raport javor, mujor, tremujor dhe vjetor, për të gjitha aktivitetet e prokurimit më të cilat është i ngarkuar;

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Përgatitje shkollore universitare (përparësi kanë fakulteti Ekonomik/Juridik) si dhe certifikatë valide, bazike apo të avancuar të prokurimit, të lëshuar nga një organ kompetent; dhe
- Të paktën 3 (tri) vjet përvojë pune, nga të cilat së paku 1 (një) vit pune profesionale në lëmin e prokurimit ose në fusha të ngjashme në institucionet/organizatat vendëse ose ndërkombëtare, të ndërlidhura me lëmin e kësaj detyre.
- Njohje e mirë e Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë; i licencuar nga autoriteti përkatës I prokurimit në Kosovë; aftësi komunikimi të zhvilluara mirë (në mënyrë verbale dhe me shkrim); përvojë e konsiderueshme për administrimin e postës elektronike dhe për përdorimin e internetit; aftësi për të punuar me efikasitet nën presion kohor; aftësi për caktimin e prioriteteve dhe për përfundimin e disa detyrave njëkohësisht; aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur me mbikëqyrje minimale, si dhe në një mjedis ekipor; aftësi e shkëlqyeshme për përdorimin e kompjuterit, veçanërisht të programeve MS Word dhe Excel; njohuri e mirë e gjuhës shqipe/serbe, duke përfshirë edhe aftësi të zhvilluara për hartimin e dokumenteve. Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave, me të paktën 180 gjer 240 kredi /ECTS
- Preferohet Certifikim i avansuar ne fushen e prokurimit apo menaxhimit te kontratave.
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të prokurimit
- Certifikat nga Gjykatat qe nuk jeni nen hetime jo ma e vjeter se nga data e shpalljes se ketij konkursi

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

Ligji për Financa dhe Përgjegjësit Publike , Ligji I Prokurimit dhe Rregulloret e Prokurimit
Ligjet tjera zbatuese në Kosovë

Mënyra e aplikimit , Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës për pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e punës në ndërmarrje. Ndermarja Ambientit Sh.A ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra.
Procedura e konkurrimit
Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.
Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në Ndërmarrje Ambientit Sh.a Pejë dhe kandidati mund të kërkoj derëgimin e aplikacionit nga ndërmarrja për mes e-mailit krm.ambienti@yahoo.com
Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Ndërmarrje Ambientit Sh.a Pejë me adresë Rr Xhem Sadrija pn , në kopje fizike.
Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit duke filluar nga data 17/01/2024 deri më datën 02/02/2024, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Data Connection” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811486407 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Data Connection” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811486407 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Data Connection” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811486407 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shala X.H- SH.P.K, N.N.SH “Shala-X.H” me nr. Unik Identifikues: 811990086. Bënë ulje të kapitalit nga 600,000.00 në 1,000.

- Florim Plakiqi I.P. N.N.T. “Flori-P” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810927882.

- Elvis Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Shtjefën Gjeqovi” Prishtinë.

- A&C Partners Restaurant L.L.C. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 812035046.

- Arber Pergjoni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotësh.f.m.u. “Mazllom Këpuska” nga kl. I-V-VI-IX.

- Nezhdet Lleshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Edonis Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, 12 dhe diploëmn e sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Albin Tahiraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjellësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi)

I. Emërtimi i vendit të punës: Bagerist (Ekskavatorist)

Përgaditja profesionale: Shkolla Fillore ose e Mesme

Përvoja e punës: Së paku 1 vit.

Numri i kryerësve: 1.

Kushtet të veçanta:

- Të jetë punëtor i kualifikuar Bagerist (Eskavatorist).

Paga Bazë: 494.37 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU “Mitrovica”.

Orari: I plotë.

Vendi i punës: KRU “Mitrovica” Sh.A Njësia Vushtrri

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat,
- Kryen projektimin e rrjetit të objektit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Bënë marrjen e urdhërave për përdorimin e makinës me të cilën është i ngarkuar personalisht përdor sipas urdhërësës,
- Pastron dhe bënë lyerjen dhe mirëmbajtjen e makinës me të cilën është i ngarkuar,
- Punonjësi është i ngarkuar dhe është përgjegjës për mjete të cilat i përkasin makinës dhe është përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre,
- Punëtori i cili punon në këtë vend të punës është përgjegjës për kryerjen e punëve me urdhërin e përgjegjës të tij,
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërësës që merr nga Udhëheqësi/sja,
- Për punën që kryen i përgjigjet Shefit të Mekanizmit

Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Shkolles së Mesme apo Dëftesa e Shkolles Fillore (orgjinali nga kopja e noterizuar, kurse jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës (trusti),
- Kopja e letërnjoftimit.

Mënvra e aplikimit:

- Aplikacionet mund të merren ueb-faqen e Kompanisë KRU “Mitrovica” Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/> si dhe fizikisht në zyrën për Burime Njerëzore, dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data 17.01.2024 deri me datën 31.01.2024.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.
- Dokumentet e pranura të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.

VËREJTJE: Kandidatët të cilët paraqesin aplikacionin e pa-plotësuar, apo nuk i bashkëngjisni dokumentet e kërkuara si në konkurs, aplikimet e tyre do të refuzohen dhe të njëjtit nuk do të i nënshtrohen procedurës së rekrutimit.



U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212 i Administrativnog uputstva za regulisanje postupaka u vezi sa oglasom za radna mesta u javnom sektoru br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici, je objavila ovaj:

OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

(Za popunjavanje slobodnih radnih mesta šest (6) meseci probni rad sa mogućnošću produženja)

I. Naziv radnog mesta: Bagerista

Profesionalna kvalifikacija: Osnovna ili Srednja Škola

Radno iskustvo: Najmanje (1) godina

Broj pozicija: (1)

Posebni uslovi:

- mora biti kvalifikovan bagerista

Osnovna plata: 494.37 €, na osnovu Uredbe o raspodeli prihoda u RVP Mitrovica

Radno vreme: Puno

Radno mesto: RVPM - Jedinica u Srbici

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- može da obavlja zadatke sa punim radnom vremenom i bez ograničenja,
- izvodi projektovanje mreže objekta vodovoda i kanalizacije,
- prima naloge za korišćenje automobila kojim je zadužen i lično ih koristi po nalogu,
- čisti i radi farbanje i održavanje automobila za koje je zadužen,
- zaposleni je zadužen i odgovoran je za alate koji pripadaju automobilu i odgovoran je za njihovo skladištenje i održavanje,
- zaposleni koji radi na ovom radnom mestu odgovoran je za obavljanje poslova po nalogu svog pretpostavljenog,
- obavlja i druge poslove po nalogu koji dobije od Vode,
- za posao koji obavlja odgovoran je Vode Mehanizma

Potrebna dokumentacija:

Zainteresovani kandidati moraju popuniti prijavu Preduzeća i uz prijavu priložiti sledeću dokumentaciju:

- CV (Biografija),
- Motivaciono pismo,
- Diploma srednje škole ili Potvrda osnovne škole (overena kopija, dok diploma sa ustanove u inostranstvu mora biti nostrifikovana),
- Dokaz nadležnog suda da nije pod istragom, ne stariji od 6 meseci,
- Dokaz o stručnom usavršavanju,
- Dokaz o radnom iskustvu (trusti),
- Kopija lične karte.

Način prijave:

- Prijave se mogu dobiti na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>, kao i fizički u Službi za ljudske resurse, i dostaviti istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom u štampanom obliku.
- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja od 17.01.2024 do 31.01.2024.
- Prijave dostavljene nakon isteka roka se ne prihvataju.
- Prihvaćena dokumenta podnosiocima prijava u fotokopijama se ne vraćaju.

NAPOMENA: Kandidatima koji podnesu nepotpunu prijavu, ili ne prilože traženu dokumentaciju kao u oglasu za konkurs, prijave će biti odbijene i neće biti predmet postupka prijema.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “SGloungebar” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812065755 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “SGloungebar” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812065755 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “SGloungebar” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 812065755 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “World of Beauty” SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Henor Mahmuti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812012904 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “World of Beauty” D.O.O. Gnjlane, sa vlasnikom Henor Mahmuti, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812012904 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “World of Beauty” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Henor Mahmuti, has come to the decision to quit its business: 812012904 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





TRADITË QË NGA

1992



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

GLUTEN FREE

100% MISH PULE

CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES